



Republika e Kosovës / Republika Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash / Skupština Opštine Dragaš



Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, qershor 2008), neni 32, paragrafi 2 i Statutit të Komunës së Dragashit. 01 nr.06-103/1 datë 11.09.2008, Kuvendi i Komunës së Dragashit, në seancën e mbajtur me 10.02.2025 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miraton këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
DRAGASHIT PËR VITIN 2025

- I. **MIRATOHET** Plani i Punës së Kuvendit të komunës së Dragashit për vitin 2025.
- II. Plani i punës së Kuvendit të komunës së Dragashit për vitin 2025 është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ndryshimet dhe Plotësimet e Planit të punës së Kuvendit mund të bëhen edhe pas miratimit të tij, pëderisa çështjet që janë në kompetencë të Kryetarit të Komunës do të shqyrtohen edhe pa qenë të përfshira në planin e punës.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesja e K.K. Dragash.
- V. Vendimi hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në webfaqen e Komunës.

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH
01 Nr. 060/01-1810-4125
Dt. 10.02.2025



Kryesuesja e Kuvendit
Arijeta Skeraj